



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.38/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterëve në trafostacion elektrik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërkaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 500.00 (pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017, në rrugën “Qazim Berisha” në Prizren, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatëve për këshilltar të Kuvendit Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, të ngjitur në hapësira publike përkatësisht në trafostacion elektrik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur posterët e kandidatëve në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017, subjekti politik PDK, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, më tej në përgjigje kanë shtuar se kanë ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterë të kandidatit për këshilltarë të Kuvendit Komunalë nga radhët e subjektit politik PDK janë vendosur në trafostacion elektrik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterë të kandidatit për këshilltar të Kuvendit Komunalë të subjektit politik PDK-së, janë vendosur në trafostacion elektrik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Partia Demokratike e Kosovës, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti poster të kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike . Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 38/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Gyltene Sylejmani**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***